



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

I. autorizohet z. Valon Potera, auditor i brendshëm në kuadër të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dërgimin e Raportit gjashtë mujor (janar – qershor 2025) lidhur me aktivitetet e auditimit të brendshëm në subjektet e sektorit publik, në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve.


II. Autorizimi jepet për shkak të mungesës së udhëheqësit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, pozitë e cila aktualisht është e lirë / e pa plotësuar.

Nr. prot. 02-016/01-0037011/25
Podujevë, datë: 01.07.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 01.07.2025, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0032264/25, të datës 11.06.2025, për përkrahje në projektin Furnizim me Mekanizëm Bujqësor Lot I, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| - Hamide Aliu Selmani , zyrtare për bujqësi – DBPZHR, | kryesuese |
| - Shefrie Gashi zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR, | anëtare |
| - Bleona Musolli , zyrtare për bujqësi – DBPZHR, | anëtare |

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.


QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0037576/25
Podujevë, datë 08.07.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 dhe 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0036536/25 të datës 30.06.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Ahmet Llalloshi, nga Podujeva për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore dhe kushteve të vështira të banimit i jepet ndihmë financiare në shumë 4000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Ahmet Llalloshi (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/03-0037575/25
Podujevë, datë, 03.07.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 dhe 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0029842/25 të datës 02.06.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Fatlum Retkoceri, nga fshati Halabak Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Fatlum Retkoceri (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/03-0037574/25
Podujevë, datë, 03. 07. 2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61.3 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr këtë:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR MBIKQYRJEN DHE PËRCJELLJEN E FUSHATËS PËR KORRJE-SHIRJE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2025

Neni 1

Ngritet Komisioni komunal për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e fushatës për korrje-shirje në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2025, në përbërje:

Behë Govori	kryesues
Eset Abdullahu	anëtar
Milaim Ajvazi	anëtar

Neni 2

Komisioni bën mbikëqyrjen dhe kujdeset për mbarëvajtjen e fushatës së korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni në formë të shkruar informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


I dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
DBPZHR
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-02/d04-0037981/25
Podujevë, datë: 03.07.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 7,650.00€, ndihmë për tridhjetetë (38) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin qershor 2025, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0038413/25
Podujevë, datë 07.07.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 73 paragrafët 1.1 dhe 1.2, nenit 74 dhe 75 të Ligjit të punës nr.03/L-212, si dhe duke u bazuar në njoftimin zyrtar të Policisë së Kosovës të datës 03.07.2025 lidhur me arrestimin e zyrtarit Skender Rudari, merr vendim;

V E N D I M

I. Skender Rudari, vozitës në Drejtorinë e Administratës në Komunën e Podujevës, i shqiptohet masa e suspendimit largim i përkohshëm nga puna me 50% të pagës por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, me efekt të menjëhershëm, përkatësisht deri në marrjen e një vendimi tjetër, lidhur me çështjen penale të iniciuar ndaj tij sipas Njoftimit zyrtar nga autoriteti policor për arrestimin e tij, si rezultat i shkakimit të veprës penale, trafikimit me narkotikë.

II. Gjatë kohës së suspendimit i përmenduri nuk do të ushtrojë asnjë detyrë apo përgjegjësi zyrtare, dhe do të trajtohet konform dispozitave ligjore në fuqi për pezullim nga puna.

Arsyetim

Vendimi merret pas pranimit të Njoftimit zyrtar nga autoriteti policor të datës 03.07.2025 lidhur me arrestimin e zyrtarit të Komunës së Podujevës Skender Rudari, me pozitë vozitës në Drejtorinë e Administratës, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe në funksion të ruajtjes së etikës institucionale, derisa organet kompetente të përfundojnë procedurat hetimore dhe gjyqësore ndaj zyrtarit në fjalë.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, zyrtari ka të drejtë ankese në Inspektoratin e Punës brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Me këtë vendim njoftohen:

z. Skender Rudari

Zyra e Personelit

QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-01E/01-0038544/25
Podujevë, datë: 07.07.2025



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 44 të Ligjit nr. 05/L-032 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. Prot. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot. 02-020/04-0074178/24, datë 14.11.2024 për ngritjen e Shtabit emergjent për mbrojtje dhe shpëtim, dhe atë:

-Ismet Kadriu, shef sektori në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, caktohet anëtar i Shtabit në vend të ish drejtorit të kësaj Drejtorie Leutrim Krasniqi.

-Vail Shala përfaqësues nga Kryqi i Kuq i Kosovës - Dega Podujevë, caktohet anëtar i Shtabit.

-Makfirete Zeka, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale-QPS, mbetet anëtare e këtij Shtabi, si përfaqësuese e QPS.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë të përshkruar në nenin 1.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

Të caktuarit dhe anëtarët e Komisionit

Zyra e Personelit

QSHQ/Arkivi


Nr. prot. 02-020/04-0039227/25
Podujevë, datë: 09.07.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Brlliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 dhe 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të 07.07.2025, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Sabri Ademi, nga fshati Dobratin, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore dhe kushteve të vështira të banimit i jepet ndihmë financiare në shumë 4000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Sabri Ademi (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/03-0033525/25
Podujevë, datë, 09.07.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, në implementim të projektit "Furnizim me pajisje për Shpezëtari" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0019103/25 të datës 04.04.2025, në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-400/03-0023689/25 të datës 28.04.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 42,857€, nga e cila 30,000€, apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 12,857€ apo 30% e vlerës participim nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Furnizim me pajisje për Shpezëtari", përkatësisht për 4 fermer përfitues, dhe atë për;

-printer automatik për vezë.....4 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me pajisje për Shpezëtari".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me pajisje për Shpezëtari", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0039615/25
Podujevë, datë, 10. 07. 2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 20 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021, nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MF-nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT

Neni 1

Themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

Sejrane Hasani,	kryesues (nga jashtë institucionit të Komunës)
Lirim Thaçi	anëtar (nga jashtë institucionit të Komunës)
Haxhere Fazliu,	anëtare (nëpunëse e Komunës)

Neni 2

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sipas detyrës zyrtare caktohet sekretar i Komitetit të Auditimit.

Neni 3

Komiteti i Auditimit është organ i pavarur këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës dhe mbështetës për Njësinë e Auditimit të brendshëm, për menaxhimin dhe kontrollin e financave publike në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësit Komiteti i ushtron në pajtim me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimin Administrativ MF-nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 5

Mandati i Komitetit është tre (3) vite.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të Komitetit

Njesisë së Auditimit të Brendshëm

QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0059943/25
Podujevë, 10.07.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 dhe nenin 6 të Rregullores për Transportin e Udhëtarëve me Automjete Taksi nr. Prot.01-345/01-0008882/23, merr:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË OPERATORËVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI DHE VERIFIKIMIN E AUTOMJETEVE

Neni 1

Formohet Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë për transportin e udhëtarëve me automjete taksi dhe verifikimin e automjeteve, të cilët kanë aplikuar sipas Njoftimit publik nr. Prot.10-334/07-0033573/25 datë 18.06.2025, në këtë përbërje:

Naime Ajeti,	kryesuese
Arbër Sfishta ,	anëtar
Qefser Vërshevc,	anëtar
Pajtime Sadiku,	anëtare
Ahmet Ahmeti,	anëtar

Neni 2

Komisioni bën shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve sipas Njoftimit publik në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të vendimit për formimin e komisionit si dhe bën verifikimin e automjeteve dhe harton raportin me listën e operatorëve të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e licencës, dhe të njëjtin ia dërgon Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-020/04-0040231/25
Podujevë, datë: 11.07.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Thirrjes publike nr.prot.09-615/03-0036275/25 të datës 27 qershor 2025 për financimin e projekt propozimeve individuale, për organizimin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, ngritet Komisioni ad-hoc në këtë përbërje:

- | | |
|---|----------|
| - Arbër Sfishta , zyrtar në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit | kryesues |
| - Blerta Ajvazi , zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik | anëtare |
| - Donjeta Fazliu , zyrtare në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | anëtare |

- **Ilir Abdullahu** zyrtar në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit caktohet anëtar rezervë në rast të mungesës së ndonjërit prej anëtarëve, konfliktit të mundshëm të interesit apo për çfarë do arsye tjetër.

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit (përmes kryesuesit)

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0040765/25
Podujevë, datë, 15.07.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Blliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës publike nr.prot.15-300/01-0035509/25 të datës 25.06.2025, për aplikim në projektin, Ngritja dhe Zhvillimi i Bizneseve, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Shkurte Musa, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillim Ekonomik
Blerta Ajvazi, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillim Ekonomik
Arben Neziri, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave

kryesuese
anëtare
anëtar

Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi, punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022 për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0040892/25
Podujevë, datë, 15.07.2025



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 25.06.2025, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0035748/25, të datës 25.06.2025, për aplikim në projektin Përkrahje me Mekanizëm për Blegtori Lot II, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- Selman Gashi , zyrtar për çështje pedagogjike - DKA	kryesues
- Blerta Ajvazi , zyrtare për regjistrimin e bizneseve - DPZHE	anëtare
- Rilind Mehanja , specialist i IT - DKA	anëtar

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0041252/25
Podujevë, datë, 16.07.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-401/01-0065086/24, të datës 26.09.2024, për miratimin e projektbuxhetit të komunës së Podujevës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore 2026-2027, në implementim të projektit "Furnizim me Pajisje për Pemëtari" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0018263/25 të datës 02.04.2025 në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0023127/25 të datës 25.04.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 18,750.00€, nga e cila 13,125.00€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, si dhe 5,625.00€ apo 30% e vlerës së participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e komunës "Furnizim me Pajisje për Pemëtari", përkatësisht për 42 fermer përfitues, dhe atë për;

- Spërkatëse.....25 fermer përfitues
-Gërshtë për krasitje me bateri.....17 fermer përfitues

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Furnizim me Pajisje për Pemëtari".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Furnizim me Pajisje për Pemëtari", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0041648/25
Podujevë, datë, 17.02.2025





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-111/01-0040438/25, datë 14.07. 2025, nxjerrë këtë;

VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “XHELADIN REKALIU” NË PODUJEVË

Neni 1

z.Agim Hamza, me vendbanim në Podujevë, me nr.personal të letërnjoftimit [REDACTED] i kualifikuar *MSC i Shkencave të Gjeografisë*,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët - SHFMU “Xheladin Rekaliu” në Podujevë

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-101/03-0040773/25
Podujevë, datë: 15.07.2025





KRYETARI I KOMUNËS

